



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.60/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.60/2026, të datës, 20.01.2026, të parashtruar nga ankuesi G.D, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.60/2026, të datës, 20.01.2026, të parashtruar nga ankuesi G.D.

II. Anulohet Konkursi me numër reference RN00018377, për Grup i Prokurimit Publik, për pozitën e punës “*Ekspert Shqyrtues*”, i shpallur me datë 30.07.2025 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Kryesuesi i Sekretariatit dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit V.G, A.nr.1831/2025, të datës 04.12.2025 si të bazuar, duke e anuluar njoftimin përfundimtar me numër protokollit 1405/2025, të datës 16.10.2025, sipas konkursit me reference RN00018337, si dhe lista me numër protokollit 1279/2025, të datës 12.09.2025, për verifikim paraprak për grup i Prokurimit Publik për pozitën “Ekspert Shqyrtues”, ndërsa çështjen e kthen në fazën e verifikimit paraprak, duke e obliguar Kryesuesin e Sekretariatit të OSHP-së, t’i ndërmarr veprimet për Themelimin e Komisionit të Pranimi, në pajtim dispozitat ligjore në fuqi.

Me qëllim të zbatimit të vendimit A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për pozitën “Ekspert Shqyrtues”, dhe sipas njoftimit me numër protokollit 1955/2025 të datës 24.12.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, rezulton se kandidatë fitues është shpallur V.I me gjithsejtë 84.8.

Ankuesi G.D. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 20.01.2026 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 319/2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018337, për Grup i Prokurimit Publik, për pozitën “Ekspert Shqyrtues”, të zhvilluar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Organin Shqyrtues i Prokurimit , ndërsa Këshilli më datë 05.02.2026 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr.60/2026 të datës 20.01.2026; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër protokollit 1906/2025, i datës 19.12.2025, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2026, dërguar nga R.K, për A.B; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 60/2026, e datës 06.02.2026; Lista e Aplikantëve; Emali i datës 18.12.2025, dërguar nga A.B, për G.D; Njoftimi i datës 30.07.2025,i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik; Emali i datës 19.12.2025, dërguar nga A.B; Emali i datës 24.12.2025, dërguar nga A.B, për V.G; Testi me shkrim i kandidatit V.G; Testi me shkrim i kandidatit V.I; Përshkrimi i detyrave të Punës për pozitën “Ekspert Shqyrtues”; Konkursi me numër referencë RN000 18337, i datës 30.07.2025; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistës i datës 26.12.2025, për V.I, nga anëtari i komisionit B.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistës i datës 26.12.2025, për V.I, nga anëtari i komisionit E.P; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistës i datës 26.12.2025, për S.B, nga anëtari i komisionit S.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistës i datës 26.12.2025, për V.I, nga anëtari i komisionit A.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistës i datës 26.12.2025, për V.I, nga anëtari i komisionit V.B; Njoftimi

me numër protokolli 1995/2025, i datës 24.12.2025; Lista Përfundimtare e Vlerësimit të Kandidateve e datës 24.12.2025; Formulari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esës së Kandidateve nga Komisioni i Pranimit i datës 26.12.2025; Njoftimi me numër protokolli 1905/2025, i datës 19.12.2025; Vendimi me numër protokolli 1909/2025, i datës 19.12.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit i nxjerr nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së; Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 26.12.2025; Aplikacioni i V.I, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 436-02/9-21, e datës 05.11.2021, për V.I, e lëshuar nga Kolegji Riinvest; Marrëveshje për angazhim me numër protokolli 05.06.2023; Akt Emërimi me numër protokolli 93/2025, i datës 29.01.2025; Kontratë për Marrëdhënies e punës me numër protokolli 3026/2023, e datës 20.12.2023; Kontratë për Marrëdhënies e punës me numër protokolli 1190/2023, e datës 20.09.2023; Vendimi me numër protokolli 1046/2025, i datës 28.07.2025; Vërtetimi mbi përvojën e punës me numër protokolli 1198, i datës 27.05.2025; Kopje e letërnjoftimit për V.I; Aplikacioni i G.D, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 447, e datës 29.09.2020, për G.D, e lëshuar nga Universiteti "Kadri Zeka"; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 15.11.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 12.02.2021; Kopje e letërnjoftimit për G.D.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Organi Shqyrtues i Prokurimit, më datë 30.07.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00018337, Grupi i Prokurimit Publik, gjegjësisht për dy(2) pozita të punës *Ekspert Shqyrtues*-Klasa Profesional 1, me afat aplikimi nga data 31.07.2025 deri më datën 29.08.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit V.G, A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025 si të bazuar, duke anuluar Njoftimin përfundimtar me numër protokollit 1405/2025, të datës 16.10.2025, sipas konkursit me numër reference RN00018337, si dhe lista me numër protokolli 1279/2025, të datës 12.09.2025, për verifikim paraprak për grupin e Prokurimit Publik për pozitën "Ekspert Shqyrtues", ndërsa çështjen e kthen në fazën e verifikimit paraprak.

Me qëllim të zbatimit të vendimit A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për pozitën "Ekspert Shqyrtues", dhe sipas Njoftimit me numër protokolli 1955/2025 të datës 24.12.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, rezulton se kandidate fitues është shpallur V.I me gjithsejtë 84.8.

Ankuesi G.D (në tekstin e mëtejshëm referuar Ankuesi), më datë 20.01.2026 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 319/2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

Procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018337, për Grup i Prokurimit Publik, për pozitën “ Ekspert Shqyrtues”, të zhvilluar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00018337, Grupi i Prokurimit Publik, gjegjësisht për dy(2) pozita të punës Ekspert Shqyrtues-Klasa Profesional 1, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Fusha e Studimit Ekonomi(pavarësisht nga specializimi), Juridik apo Administratë Publike;*
- *Kushtet specifike; Certifikata licenca ku kërkohen me legjislacionin në fuqi, apo kur vlerësohet së janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.* 2. *Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së.* 3. *Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse.* 4. *Përfshihet përcaktimet e këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni.* 5. *Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.* 6. *Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit.* 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.* 8. *Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi.* *Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.* 10. *Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.* 11. *Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit.* *Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit.* *Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

Kolegji i Këshillit, nga shkesat e lendes konstaton se Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimi të vendimit A.Nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, procedurën e rekrutimit sipas konkurset referencës RN00018337, Grupi i Prokurimit Publik, gjegjësisht për dy (2) pozita të punës Ekspert Shqyrtues-Klasa Profesional 1, e ka kthyer në fazën e verifikimit e Themelimit të Komisionit të Pranimit, mirëpo edhe përkundër faktit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka kthyer çështjen në fazën e verifikimit të Themelimit të Komisionit të Pranimit Organi Shqyrtues i Prokurimit, mirëpo Komisioni Përzgjedhës i Organit Shqyrtues pas pranimi të vendimit të Këshillit ka zhvilluar procedurat e rekrutimit dhe me datën 26.12.2026, me numër protokolli 1976, ka bërë njoftimin mbi rezultatet përfundimtare përmes të cilit njoftim rezulton se kandidatë fitues është shpallur V.I me gjithsejtë 84.8, për pozitën "Ekspert Shqyrtues", e që është e njëjta sipas vendimit të Këshillit A.nr. 1831/2025, të datës 04.12.2025, nuk i ka plotësuar kushtet për tu përzgjedhur në pozitën "Ekspert Shqyrtues".

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, në rastin e zbatimit të vendimit A.nr. 1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: "21.1. *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës*, sepse në rastin konkret Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka vepruar sipas vendimit A.nr. 1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, ku sipas vendimit të Këshillit Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka qenë e obliguar që të zbatojë vendimin e Këshillit e në rastin konkret nuk ka marrë për bazë vendimin sepse ka përzgjedhur kandidaten e njëjte si kandidatë fitues, e cila sipas vendimit të Këshillit nuk i ka plotësuar kushtet për tu përzgjedhur si kandidatë e suksesshme për pozitën "Ekspert Shqyrtues", sepse siç është përcaktuar në vendimin A.nr.1831/2025, të datës 04.12.2025, të Këshillit, kandidatja V.I, e cila për nga përgatitja profesionale/ arsimit posedon Diplomën e datës 05.11.2021 të lëshuar nga kolegji Rinvest me të cilën mori titullin Bachelor i Arteve në Menaxhimin e Biznesit, ndërsa lidhur me përvojën e punës ka ofruar si dëshmi marrëveshjen për angazhim për Punë-Praktike në Ministrinë e Financave prej datës 01.06.2023 deri me 19.09.2023, e cila a kryer punë tekniko- administrative, tutje me datë 20.12.2023 ka themeluar marrëdhënien e punës në OSHP për kohë të caktuar nga data 20.09.2023 deri me 20.09.2024 si nëpunës Administrativ dhe mbështetës në të cilën pozite ka kryer punë administrative, duke u kujdesur për telefonatat, posten, ka menaxhuar kalendarin e takimeve dhe organizimeve të kryetarit të OSHP-se, ndërsa me datë 20.09.2024 deri me datë 20.12.2024 sipas kontratës për marrëdhënie me afat të caktuar ka mbajtur pozitën e punës Zyrtare ekzekutive në OSHP e cila ka kryer punë duke siguruar mbështetje administrative përfshirë posten zyrtare, telefonin ka përgatit dhe modifikua dokumentet duke përfshirë korrespondenca, raportet, memorandumet, agjendat, ka ruajtur dhe mirëmbajtur sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve të kryetarit të OSHP-së, si dhe me datë 29.01.2025 e njëjta ka themeluar marrëdhënien e punës sipas Akt emërimit me numër 93/25 në Organin Shqyrtues në OSH, në pozitën e punës "Zyrtare Ekzekutive" pa afat, andaj kolegji i këshillit pas analizimit të përvojës së punës ka konstatuar se kandidatja V.I ka gjithsej përvojë të punës 2 vite e 14 ditë në pozitën si "Asistente Ekzekutive" në të cilën pozitë ka kryer punë tekniko administrative e cila nuk përputhet me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Ekspert Shqyrtues" ashtu siç është kërkuar sipas konkursit të datës 30.07.2025 ku përvoja e punës është kërkuar në fushën për të cilën zhvillohet procedura.

Si rrjedhojë, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimi të vendimi të Këshillit, duhet ta anuloj konkursin e datës 30.07.2025 me numër të referencës RN00018337, për Grupin i Prokurimit Publik, për pozitën ” Ekspert Shqyrtues”, si dhe njoftimin e datës 26.12.2025, për përzgjedhjen përfundimtare për kandidatin fitues për pozitën ” Ekspert Shqyrtues”, dhe të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.60/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, G.D.;
- Kryesuesi i Sekretariatit dhe Menaxheres së Burimve Njerzore në OSHP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.